



Sisteme për shtrim të qeramikës

K511c.rs

Fletushkë teknike

01/2022



Knauf K3

Ngjitës elastik për pllaka C2TE

Përshkrimi i produktit

Ngjitës i parafabrikuar për pllaka, me bazë çimentoje. I dedikuar për vendosje të pllakave qeramike, graniti dhe gres për dysheme dhe për mure, të formateve deri 60 x 60 cm (sipërfaqe deri 0,4m²). Për zbatim të jashtëm dhe të brendshëm

Përbërja e produktit

Çimento, gurë i klasifikuar gëlqerorë, polimere redisperguese, fibra speciale, aditivë për përpunim ngjitjeje.

Forma e furnizimit

Thes 25 kg numri i produktit 596700

Magazini

Thasët të deponohen mbi paleta druri në vend të thatë

Kualiteti

Produkti i nënshtrohet kontrollit të vazhdueshëm të kualitetit dhe bartë shenjën CE. Materiali të shpenzohet brenda afatit prej 12 muajve pas ditës së prodhimit.

Fushat e zbatimit

- Vendosja e pllakave për mure dhe dysheme me absorbim të dobët graniti dhe gres të formatit deri 60 x 60 cm, sipërfaqe deri 0,4 m² sipas SRPS EN 14411
- Për zbatim të jashtëm dhe të brendshëm
- Për zbatim mbi mallë çimentoje dhe/apo masave për nivelim
- Për zbatim mbi mure të suvatuara dhe/apo pllaka gipsi
- Për vendosje të pllakave mbi pllaka

- Për sisteme me ngrohje dyshemeje
- Për zbatime në pishina
- Vendosje të pllakave mbi hidro-izolime polimeri çimento Knauf

Vetitë

- Ngjitës çimentoje për pllaka C2TE sipas SRPS EN 12004
- Vetë të jashtëzakonshme ngjitëse
- Nuk ka rrëshqitje të pllakave
- Kohë e hapur e zgjatur për punë
- Rezistues ndaj acarit
- Elastik
- Shtresë hollë Rezistues ndaj acarit
- Ngjyrë hiri

Ekzekutimi

Sipërfaqja mbi të cilën vendoset ngjitësi	Përgatitja e sipërfaqeve
Sipërfaqet jo mbajtëse	Hiqen të gjitha shtresat jo bartëse
Sipërfaqe jo të rrafshëta me zgavra	Zgavrat mbushen dhe rrafshohen me materiale gjegjëse reparature
Nivelizim çimentoje, masa çimentoje për rrafshim të dyshemeve	Lyerje bazë me Knauf Finish Grund / Tiefengrund dhe pritni të thatet
Sipërfaqe muresh të suvatuara apo pllaka gipsi	Lyerje bazë me Knauf Finish Grund / Tiefengrund dhe pritni të thatet
Sipërfaqe betoni	Lyerje bazë me Knauf Spezialhaftgrund
Pllaka ekzistuese qeramike	Lyerje bazë me Knauf Spezialhaftgrund

Punët përgatitore

Sipërfaqja mbi të cilën vendosen pllakat duhet të jetë e thatë, pa pluhur, pa yndyra, bartëse, e rrafshët dhe pa mbetje të cilat e ulin aftësinë lidhëse të ngjitësit. Para vendosjes së ngjitësit, sipërfaqja të përgatitet sipas tabelës „Përgatitja e sipërfaqeve”.

Përgatitja e materialit

Përmbajtjes së thesit (25 kg) i shtohen 8 litra ujë të pastër dhe përzihet deri sa masa të bëhet homogjene. Pas kësaj, materialin e përgatitur e leni të qëndron 5 minuta dhe pastaj e përzieni edhe njëherë. Sipas nevojës konsistenca rregullohet me shtim të ujit apo pluhurit. Koha e hapur e ngjitësit të shtruar (për punë dhe korrigjim) është rreth 30 minuta. Materialin e përgatitur në kovë ta përdorni në një afat prej 5 orësh. Mjetet e punës pastrohen menjëherë pas përfundimit.

Ekzekutimi

Mbi sipërfaqen e përgatitur paraprakisht vendosni mbi tërë sipërfaqen ngjitësin, me shtresë të hollë dhe e shpërndani me mistri gjegjëse të dhëmbëzuar. Pllaka vendoset mbi ngjitësin e vendosur freskët dhe e shtypni me fuqi të mjaftueshme, ashtu që të formohet lidhja adekuatë në mes të ngjitësit dhe pllakës. Sipas nevojës, për vendosje të pllakave shfrytëzoni veprimet „floating and buttering”, gjegj. pllakën e lyeni hollë në tërë sipërfaqen me ngjitës si dhe sipërfaqen mbi të cilën vendosen pllakat. Trashësia e përgjithshme ngjitësit pas vendosjes së pllakave nuk guxon të jetë më tepër se 5 mm.

Në rast të formimit të koreve (prova me gisht) ngjitësin e ngurtësuar duhet hequr dhe vendosni sipërfaqe të re ngjitësi.

Temperatura e punës

Materiali nuk guxon të vendoset pranë temperaturave të ajrit dhe të shtresës më të ulëta se +5°C dhe më të larta se 25°C. Ngjitësin e freskët të vendosur mbron nga shkuji, tharjes së shpejtë dhe acarit.

Udhëzime të veçanta:

- Klasa më e ulët e fortësisë ndaj presionit të suvasë mbi të cilën vendosen pllakat duhet të jetë CSII
- Ngjitësi vendoset hollë. Trashësia e gjithmbarshme pas vendosjes: deri 5 mm
- Ecja mbi pllaka: pas 24 orëve
- E gatshme për shfrytëzim: pas rreth 14 ditëve
- Fugat vendosen vetëm pas tharjes së plotë të ngjitësit
- Gjatë vendosjes së ngjitësit mbi sipërfaqe dyshemeje me ngrohje, ngrohja duhet të jetë e shkuçur (së paku 24 orë para fillimit të punëve)

- Zbatohet në pishina vetëm me masa fuge epokside, të cilat mbyllin ujin, pas tharjes së tërësishme të ngjitësit
- Ngjitësi përzihet vetëm me ujë të pastër dhe pa shtim të aditivëve
- Pajisjet dhe mjetet e punës të pastrohen menjëherë pas kryerjes së punës

Udhëzime sigurie:

Për udhëzime sigurie shiko fletushkën e sigurisë.

Të dhënat teknike

SRPS EN 12004

	Vlera	Norma për prova
Fortësia fillestare e ngjitjes	≥ 1,0 N/mm ²	SRPS EN 1348
Fortësia e ngjitjes, pas ekspozimit ndaj ujit	≥ 1,0 N/mm ²	SRPS EN 1348
Fortësia e ngjitjes, pas vjetërsimit termik	≥ 1,0 N/mm ²	SRPS EN 1348
Fortësia e ngjitjes, pas ciklit ngrirje-shkrirje	≥ 1,0 N/mm ²	SRPS EN 1348
Reaksioni ndaj zjarrit	Klasa E	SRPS EN 13501-1+A1

Të dhënat teknike në këtë tabelë janë konstatuar sipas normave të vlefshme. Përmes kushteve në punishte mund të ketë devijime të vogla.

Shpenzimi i materialit

	Gjerësia dhëmbëve në mistri mm	Shpenzimi kg/m ²
Ngjitja	4	2,0
	6	3,0
	8	3,5
	10	5,0

Të gjitha të dhënat mbi shpenzimin janë të përafërta dhe mund të ndryshojnë varësisht prej sipërfaqes se ku vendoset materiali. Shpenzimi i saktë konstatohet në punishte.

Programi i prodhimitarisë

K3	Paketimi	copë/paletë	numri i produktit	EAN kod
Thes	25 kg	54 thasë/paletë	596700	4006379047529



Keni kujdes në fletën e sigurisë!

Fleta e sigurisë dhe CE shenja shifet në

www.knauf.al

▶ Tel: +383 38 733 320

▶ info-ks@knauf.com

▶ www.knauf.al

Knauf Zemun d.o.o. Batajnicksi drum 16 b, 11080 Zemun

Të gjitha ndërrimet teknike të rezervuara. I vlefshëm është vetëm versioni aktual i shtypur. Të dhënat e paraqitura i përgjigjen njohurive momentale teknike. Rregullat e përgjithshme të teknikës së ndërtimit, normat dhe rregulloret duhet të respektohen nga ana e ekzekutuesit.

Garancia jonë i referohet vetëm kualitetit pa të meta të produkteve tona. Të dhënat mbi shpenzim, sasinë dhe mënyrën e punës janë të dhëna empirike, dhe në rast të devijimit nuk mund të përdorën në praktikë. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Të gjitha ndryshimet, ri shtypjet apo fotokopjet, tërësisht apo fragmentet e tyre, kërkojnë leje të posaçme nga prodhuesi.

Cilësitë e garantuara të konstruksionit, statikës dhe atyre të fizikës së ndërtimit, mund të sigurohen vetëm atëherë kur përdoren vetëm komponentë të sistemeve Knauf apo të rekomanduara nga ana e Knauf.

KNAUF